

# Të Mësojmë nga Konferenca

## Duke Parë drejt Tempullit

Ndiq labirintin për të shkuar në tempull. Çfarë është diçka që mezi e pret rreth vajtjes në tempull një ditë?



“Tempulli hap udhën drejt bekimeve më të larta që Ati ynë në Qiell ka për secilin prej nesh.”

Plaku Ronald A. Rasband

Këtu janë tempujt më të rinj që u njoftuan në konferencë! Qarko atë që do të jetë më afër teje.

Reinosa, Meksikë

Çorijos, Peru

Rivera, Uruguaj

Kampo-Grande, Brazil

Porto, Portugali

Ujo, Nigeri

San-Hoze-del-Monte, Filipine

Njumea, Kaledonia e Re

Liverpul, Australi

Kolduell, Ajdaho, SHBA

Flegstaf, Arizonë, SHBA

Rapid-Siti, Dakota e Jugut, SHBA

Grinvill, Karolina e Jugut, SHBA

Norfolk, Virxhinia, SHBA

Spanish-Fork, Jutë, SHBA

## Dëgjimi i Konferencës



Gjatë konferencës, familja ime dhe unë i emërtojmë tasat e karameleve me fjalë si *besimi*, *tempulli* dhe *lutja*. Kur dëgjojmë njëherë nga fjalët, mund të marrim karamela nga tasi me fjalën përkatëse. Këto fjalë më ndihmojnë të mendoj për Jezusin dhe t'i dëgjoj bisedat.

**Xhejn C., 6 vjeçe, Kebek, Kanada**



Më pëlqen konferenca e përgjithshme sepse nëpërmjet bisedave mund të ndiej Frymën e Shenjtë dhe të mësoj më shumë rreth Jezu Krishtit.

**Tomas P., 8 vjeç, Buenos-Ajres, Argjentinë**



## Ejani te Krishti

Plaku Geri E. Stivenson dha mësim se simboli i Kishës na kujton që Krishti është qendra e Kishës sonë dhe se duhet të jetë edhe qendra e jetës sonë.



KISHA E  
JEZU KRISHTIT  
E SHENJTORËVE TË  
DITËVE TË MËVONSHME



HIQ NJË VIJË PËR TË PËRPUTHUR PËRSHKRIMIN ME SECILËN PJESË TË SIMBOLIT.

- Guri i qoshes është guri më i rëndësishëm në themelet e një ndërtese. Emri i Kishës është brenda një guri qosheje për të na kujtuar se Jezu Krishti është Guri Kryesor i Qoshes.
- Krahët e shtrirë të Shpëtimtarit përfaqësojnë premtimin e Tij për t'i përqaftuar të gjithë ata që vijnë tek Ai.
- Harku nën të cilin qëndron Jezu Krishti, përfaqëson çastin kur Ai doli nga varri, i ringjallur. Ai jeton dhe ne e ndjekim Atë!